

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Krimeve të Rënda-** Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykuese, me sekretaren juridike Bute Ramosaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit G. Sh. nga Tirana, për shkak të veprës penale dhënie e ryshfetit nga neni 429 prg 1 te KPRK-se, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I. nr. 45/17 të datës 10.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **24.08.2017**, në prezencën e Prokurores se Shtetit Shpresa Bakija, të akuzuarit G. Sh. se bashku me mbrojtësin e tij av. S. D. nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **G. SH.**, i biri G. dhe i F. e gjinisë M., data e lindjes..., në Tiran, ku edhe jeton, ne rrugën “...” i pa shkolle, i martuar, i ati një fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, posedon letërnjoftim me numër personal ID..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë.

### ËSHTË FAJTOR

Me dt. 01.06.2017, në ora 03:30 min, në hyrje në pikën kufitare “Qafe Prushi” nga Shqipëria në Kosovë duke drejtuar automjetin e tipit “D. K.” me targa..., në momentin kur oficeri A. B., i ka kërkuar dokumentet së bashku me librezën e automjetit me qëllim te hyrjes në Kosovë, i njëjti i ka parashtruar dokumentet dhe aty kishte future 20€, dhe kur oficeri i ka thënë për çka janë këto ai është përgjigjur “Shko pije një kafë dhe lejona të kalojmë se nuk kam autorizim për drejtimin e automjetit dhe pas kësaj i njëjti është arrestuar.

**me çka ka kryer veprën penale dhënie e ryshfetit nga neni 429 prg 1 te KPRK-se.**

**Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 49, 50, 51, 52 prg 1, 73, neni 429 prg 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, ia shqipton:**

### DËNIMIN ME KUSHT

**Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 ( tre) muaj, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 ( një) vite, nuk kryen vepër tjetër penale.**

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **50,00 €** në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

**Konfiskohet** kart monedha prej 20€, me numër serik SC 1273403082, e cilat është objekt i kryerjes së kësaj vepre penale.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP/I. nr. 45/17 të datës 10.07.2017, ka akuzuar G. Sh. nga Tirana për shkak të veprës penale dhënie e ryshfetit nga neni 429 prg 1 të KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestarë ku prezent ka qenë përfaqësuesja e akuzës Prokurorja e Shtetit Shpresa Bakija, i akuzuari G. Sh. si dhe mbrojtësi i tij av. S. D. nga Gjakova i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestar Gjykata është e bindur se këtu i akuzuari G. Sh. ka kuptuar aktakuzën, dhe i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë në kuptim të neni 326 të KPPK-së, kështu që pas konsultimeve të bëra më të mbrojturin e tij i njëjti ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimin të fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehjen e vullnetit të tij të lirë, pasi që është kryes i kësaj veprë penale andaj në tërësi ka pranuar fajësinë sipas të gjitha pikave të akuzës, se pranimi i fajësisë është i mbështetur në provat të cilat i janë ofruar Gjykatës në aktakuzë dhe atë, nga raporti i oficerit A. B., i dt. 01.06.2017, vërtetimi mbi sekuestrimin e kartëmonedhës në vlerë prej 20€, deklarata e zyrtarit policore dhe të akuzuarit të dhënë në polici si dhe provat tjera materiale që janë në shkresat e lëndës.

Pas deklarimit të akuzuarit G. Sh. për pranimin e fajësisë Kryetari i Trupit Gjykuese kërkoi që mendimin e vet të jep Prokuroria e Shtetit.

Prokurorja e Shtetit Shpresa Bakija ka deklaruar : pajtohet me deklarimin e të akuzuarit G. Sh., mbi pranimin e fajësisë dhe konsideron se një deklarim i tillë është plotësisht i vullnetshëm nga ana e të akuzuarit dhe i njëjti deklarim mbështet në prova që janë në shkresat e lëndës nga raporti i oficerit A. B., i dt. 01.06.2017, vërtetimi mbi sekuestrimin e kartëmonedhës në vlerë prej 20€, deklarata e zyrtarit policore dhe të akuzuarit të dhënë në polici si dhe provat tjera materiale që janë në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar Kryetarit të Trupit Gjykuese që të aprovoi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit G. Sh., av. S. D., deklaroi se me pranimin e fajit të akuzuarit mbrojtja konsideron se duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e veprimeve të mbrojturit tim në rastin konkret i njëjti ka qenë në lajthim sepse bashkë udhëtari njeri nga të cilët e ka pasur timonin e ka mashtruar se nuk kam autorizim edhe pse ky nuk ka pasur, edhe këto rrethana i ka përmendur si shtesë, faktin se e ka pranuar fajin si rrethanë lehtësuese që Gjykata të këtë parasysh edhe këtë fakt në mënyrë që verdikti i Gjykatës të jetë në minimale dhe sipas mundësisë nën minimale, për vepër penale e cila i vihet në barrë të mbrojturit tim, dhe mundësisht dënim të i kushtëzohet edhe për rrethanat që është nga shteti tjetër.

Pasi që Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e fajësisë e ka bërë në bazë vullnetare, Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë ka mbështetur në provat që i përmbanë aktakuza siç janë Stacioni Policore në Gjakovë, - Njësi Rajonale i Hetimeve për Krime Ekonomike dhe Korrupsion Gjakovë më numër rastit 2017-ZWP-02, të dt. 01.06.2017, foto-dokumentacioni, deklarata e të akuzuarit të dhënë në Stacionin Policore në Gjakovë, andaj Gjykata ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së, ka bërë pranimin e fajësisë së nga i akuzuari dhe shqyrtimin e ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv të Aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, ka marr parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, jodënushmëria e mëparshme të akuzuarit, është mbajtës i vetëm i familjes, i ati i një fëmijëve, e të cilat rrethana lehtësuese ka ndikuar që Gjykata ti shqiptoi, dënimin e kushtëzuar dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) vite, nuk kryen vepër tjetër penale, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin bankënotës në apoen prej 20 (njëzet)€, me numër serik SC 1273403082 është marrë bazuar në nenin 69 të KPPK-se, dhe e njëjta banknot do të dorëzohet në Agjension për administrimit e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar si Organ kompetent për sekuestrimin e pasurisë së konfiskuar., e cila është objekt i veprës penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË,-Departamenti për Krime të Renda  
PKR. nr. 73/17 më date 24.08.2017**

**Sekretarja juridike  
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari  
Shaqir Zika**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afet prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.